

### Mirë se erdhët në EPALE



**EPALE** (Electronic Platform for Adult Learning in Europe) është platformë evropiane, transparente, shumëgjuhësore e dedikuar për të gjithë ata të cilët kanë ose duan të kenë rol profesional në arsimin e të rriturve në Evropë. U themelua në vitin 2014 nga Komisioni Evropian Drejtoria e Përgjithshme për Arsim, Rini, Sport dhe Kulturë, si rezultat i sfidave në fushën e arsimit të të rriturve në mbarë Evropën, siç janë: diversiteti brenda sektorit, diferencat midis sistemeve të arsimit të të rriturve, niveli i ulët i bashkëpunimit midis shteteve, financimi etj.

Kjo platformë u dedikohet mësimitdhënësve, profesorëve, trajnuesve, hulumtuesve, vendimmarrësve, edukatorëve, studentëve nga fusha e arsimit të të rriturve. Gjithashtu, edhe personat individual mund t'i bashkëngjiten kësaj Platforme, pavarësisht nëse janë të punësuar, të punësuar me kohë të caktuar, bashkëpunëtorë me honorar, vullnetarë ose ekspertë të pavarur.

Platforma EPALE fokusohet në tema nga më të ndryshmet që kanë të bëjnë me trajnimin e të nxënit të të rriturve. Ajo mundëson qasje interaktive që nënkupton pjesëmarrje aktive të përdoruesve dhe ofron mundësi për:

Përsosjen e njohurive përmes resurseve në dispozicion të Platformës (publikime, punime shkencore, blogje dhe përmbajtje të tjera të ndryshme);

Shkëmbimin e përvojave me kolegë nga Evropa në tema që kanë të bëjnë me arsimin e të rriturve.

### *Si ANËTAR I REGJISTRUAR në EPALE keni mundësi:*

Të inicioni dhe/ose të merrni pjesë në diskutime për tema të ndryshme nga fusha e arsimit të të rriturve në mbarë Evropën;

Të shkëmbeni ide, resurse dhe praktika të mira;

Të krijoni hapësirë personale për bashkëpunim, e cila mundëson në një grup të kufizuar dhe të mbyllur t'i shqyrtoni idetë për projektet rrjedhëse dhe/ose për projektet e ardhshme me partnerët tuaj;

Ta promovoni organizatën/institucionin tuaj, aktivitetet të cilat i zbatoni dhe rezultatet që i arrini tek një rreth më i gjerë i personave të interesuar;

Ta ngritni nivelin e internacionalizimit të punës tuaj, të gjeni partner për projektet e ardhshme dhe ta krijoni rrjetin tuaj trans-nacional;

Të postoni blogje, ngjarje dhe resurse.

Përveç mundësive të theksuara, EPALE iu mundëson institucioneve ta prezantojnë punën e tyre dhe të përfshihen në bazën e institucioneve, me ç'rast bëhen të dukshme dhe lehtësisht mund të identifikohen nga institucionet e tjera për përfshirjen e tyre në projekte të përbashkëta. Veç tjerash EPALE, u ofron mundësi individëve dhe institucioneve të përgatiten që të marrin pjesë në krijimin dhe zbatimin e këtyre projekteve, me çka mund të kontribuojnë në avancimin e arsimit për të rritur.

### *Shërbimi Nacional për Mbështetje*

Nga viti 2019, për herë të parë, Republika e Maqedonisë së Veriut i bashkëngjitet familjes evropiane të Rrjetit EPALE. EPALE Shërbimi Nacional për Mbështetje të Republikës së Maqedonisë së Veriut funksionon në kuadër të Agjencisë Nacionale për Programe Arsimore Evropiane dhe Mobilitet.

EPALE KNM e identifikon përmbajtjen e rëndësishme në nivel nacional, vendos dhe mban kontakte me partnerët social në shtet, si dhe me KNM të tjerë.

EPALE Shërbimi Nacional për Mbështetje ofron mbështetje teknike dhe udhëzime për anëtarët e regjistruar në Platformën EPALE për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me regjistrimin, si të gjendet një përmbajtje ose funksion i caktuar në portal (për shembull, ku mund të publikohet një ngjarje), dhe në rast të vështirësive teknike gjatë përdorimit të Platformës. Përveç kësaj, Shërbimi Nacional për Mbështetje implementon aktivitete, me qëllim të mbështetjes së sektorit për arsimin e të rriturve: seminare, konferenca, trajnime, punëtori dhe aktivitete të tjera.

Aktivitetet në vitet e para:

Promovimi i rëndësisë së arsimit të të rriturve dhe përafrimi i mundësive të Platformës deri te grupe të synuara të ndryshme;

Ndërgjegjësimi për rëndësinë e arsimit të të rriturve dhe pozicionimi më i mirë i tij në politikën arsimore;

Ngritja e shkallës së internacionalizimit të institucioneve të arsimit të të rriturve përmes promovimit të mundësive për përfshirje në projekte të përbashkëta;

Përdorimi aktiv i EPALE si një burim i rëndësishëm për arsimin e të rriturve.

## *Aktivitetet tona në vitin 2019*

Më shumë se 200 përdorues të regjistruar në EPALE në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

Mbi 100 postime nga përdorues maqedonas të postuara në këtë Platformë;

Mbi 20 ngjarje promovuese të organizuara nga KNM dhe ambasadorët EPALE;

EPALE u prezantua para përfaqësuesve të komunave, provajderëve të arsimit të rriturve, grupeve nacionale të punës, organizatave joqeveritare, studentëve të shkencave andragogjike dhe pedagogjike, institucioneve kulturore, bibliotekave, muzeve dhe para sektorit të biznesit;

Ambasadore të trajnuara;

Më shumë blog postime të shkarkuara, të përkthyer dhe të publikuara në gjuhë të tjera;

Një blog postim u shpall në mesin e tre postimeve më të lexuara në EPALE në muajin tetor të vitit 2019;

U realizua bashkëpunim me Koordinatorin Nacional për implementimin e agjendës për të nxënit në Evropë, MASH, Qendrën për Arsimin e të Rriturve, Shërbimet Nacionale EPALE për mbështetje brenda rajonit dhe më gjerë;

Mbi 1600 ndjekës të EPALE në rrjetet sociale;

Sinergji e realizuar me programe dhe rrjete të tjera të BE.

## *Fokusime tematike për vitin 2020*

Janar, shkurt, mars: “Ndërgjegjësimi për mjedisin jetësor dhe mbrojtjen e tij”;

Prill, maj, qershor: “Aftësi digjitale si mënyrë për sigurimin e mundësive për nxënie”;

Korrik, gusht, shtator: “Mundësi për përvetësimin e aftësive themelore”;

Tetor, nëntor, dhjetor: “Përfshirja sociale e popullatës e cila plaket dhe të nxënit e grupmoshave të ndryshme”.





## Si të regjistroj profil personal në EPALE

Plotësoni Formularin për regjistrim;

Kontrolloni edhe një herë se a janë të sakta të dhënat e shënuara, veçanërisht adresat elektronike dhe numri i telefonit;

Kontrolloni postën tuaj elektronike-së shpejti pas regjistrimit do të pranoni mesazh me konfirmim për procesin e suksesshëm të regjistrimit;

Brenda disa ditëve, në adresën e njëjtë do të pranoni mesazh me link për qasje në Platformë. Vendosni fjalëkalim, dhe me këtë regjistrimi përfundon;

Profilu juaj është aktiv dhe i dukshëm. Mund të krijoni përmbajtje (blogje, lajme, ngjarje, resurse), të merrni pjesë në diskutime, të komentoni përmbajtje dhe të keni qasje në seksionin Bashkësitë për shkëmbimin e përvojave.



## Si të publikoj BLOG post në EPALE

Dëshiron ta shkëmbesh mendimin tënd në një temë të caktuar që ka të bëjë me arsimin e të rriturve? Shkëmbeji opinionet e tua me kolegët nga e mbarë Evropa! Postimi i blogut në EPALE është me të vërtetë i thjeshtë, vetëm duhet t'i ndjekësh hapat në vijim.

**Hapi 1: Mendo:** Zgjidh një temë interesante dhe aktuale që ka të bëjë me arsimin e të rriturve;

**Hapi 2: Shkruaj:** Shkruaje blog postin tënd. Bëhu kreativ/e;

**Hapi 3: Kontrolllo:** Kontrolllo nëse postimi yt është kompatibel me politikën e publikimeve të About page;

**Hapi 4: Postoni:** Kliko “Propozo Blog post” në seksionin Blog në mënyrë që ta publikosh postimin tënd;

**Hapi 5: Aprovimi:** Kur blogu do të aprovohet nga EPALE Shërbimi Nacional për Mbështetje, atëherë do të paraqitet në Platformë.



## Si të publikoj NGJARJE në EPALE

A njuh dikë që organizon, ose organizata e juaj organizon ndonjë ngjarje (konferencë, event, trajnim, kurs, KHMO etj.) për arsimin e të rriturve? Promovoje ngjarjen tënde në mbarë Evropën vetëm me disa hapa. Një përkujtim i vogël: Për dallim nga postimet e tjera, NGJARJET mund të publikohen edhe në gjuhën maqedonase!

**Hapi 1: Kontrolllo:** Ndoshta ngjarja tanimë është publikuar në EPALE;

**Hapi 2: Sqaro:** Kliko “Suggest an event” dhe plotësoi të gjitha fushat që kërkohen;

**Hapi 3: Kontrolllo:** Kontrolllo nëse postimi yt është kompatibil me politikën e publikimeve të About page;

**Hapi 4: Posto:** Kliko “Propozo Risi” në seksionin Risi që ta publikosh postimin tënd;

**Hapi 5: Aprovimi:** Kur postimi do të aprovohet nga EPALE Shërbimi Nacional për Mbështetje, atëherë do të paraqitet në Platformë.



## Si të publikoj LAJM në EPALE

Keni ndonjë lajm që ka të bëjë me arsimin e të rriturve? Shkëmbeji lajmet e tua me kolegët nga mbarë Evropa! Publikimi i LAJMIT në EPALE është me të vërtetë i thjeshtë, vetëm duhet t'i ndjekësh hapat në vijim.

**Hapi 1: Kontrolllo:** Ndoshta lajmi tanimë është postuar në EPALE;

**Hapi 2: Shkruaj:** Shkruaje lajmin me fjalë të tua dhe shënoje burimin;

**Hapi 3: Kontrolllo:** Kontrolllo nëse të dhënat e shënuara janë të sakta dhe a janë respektuar rregullat e shkëmbimit;

**Hapi 4: Aprovimi:** Kur postimi do të aprovohet nga EPALE Shërbimi Nacional për Mbështetje, atëherë do të jetë paraqitet në Platformë;

**Hapi 5: Shkëmbe:** Pas publikimit të ngjarjes, me kopjimin e thjeshtë të linkut të njëjtin në mënyrë të lehtë mund ta shkëmbesh në rrjetet sociale, ose ta postosh në adresat përkatëse elektronike.



## Si të publikoj RESURS në EPALE

Në punën tënde shpeshherë krijon raporte, analiza dhe punime të tjera të ndryshme nga fusha e arsimit të të rriturve? Shkëmbeji resurset tua me kolegët nga mbarë Evropa! Publikimi i lajmit në EPALE është me të vërtetë i thjeshtë, vetëm duhet t'i ndjekësh hapat në vijim.

**Hapi 1: Kontrolllo:** Në Qendrën e Resurseve për çdo ditë publikohet një numër i madh i resurseve. Kontrolllo ndoshta resursi yt tanimë është aty;

**Hapi 2: Sqaro:** Kliko në “Suggest new resource” dhe shkruaj një rezymë të shkurtër për resursin tënd;

**Hapi 3: Posto:** Postoje resursin dhe shënoje linkun në fushën përkatëse;

**Hapi 4: Kontrolllo:** Kontrolllo nëse të dhënat e shënuara janë të sakta dhe a janë respektuar rregullat e shkëmbimit;

**Hapi 5: Aprovimi:** Kur postimi do të aprovohet nga EPALE Shërbimi Nacional për Mbështetje, atëherë do të paraqitet në Platformë.

### Udhëzime për cilësi

Publikimet detyrimisht duhet t'u referohen temave që kanë të bëjnë me arsimin e të rriturve, prioritetet nacionale dhe evropiane, si dhe me punën e personave të cilët merren me arsimin e të rriturve. Teksti duhet të ketë një rrjedhë koherente, strukturore dhe logjike. Tekstet duhet të jenë të shkurtër, me fjali të qarta dhe lehtësisht të lexueshme dhe të përshtatura për publikim në internet. Nëse është e mundur, përdoren nëntituj, pasuse të shkurtra, lista dhe theksimi i çështjeve më të rëndësishme.

Gjuha – E përdorim gjuhën angleze. Publikimet mund të postohen edhe në gjuhën maqedonase, me ç'rast Shërbimi Nacional për Mbështetje do ta sigurojë përkthimin. Në gjuhën maqedonase mund të publikohen vetëm ngjarje.

Drejshkrimi dhe gramatika – tekstet e publikuara gramatikisht janë të sakta, pa gabime shtypi.



EPALE Shërbimi Nacional për Mbështetje  
*EPALE National Support Service*  
Agjencia Nacionale për Programe Evropiane dhe Mobilitet  
*National Agency for European Educational Programmes and Mobility*  
epale@na.org.mk  
++389 2 3109 045  
Facebook: *EPALE North Macedonia*  
“Kuzman Josifovski-Pitu” nr. 17, Shkup  
“Kuzman Josifovski Pitu” nr. 17 Skopje  
Republika e Maqedonisë së Veriut  
*Republic of North Macedonia*



Национална агенција  
за европски образовни  
програми и мобилност



With the support of the  
Erasmus+ Programme  
of the European Union

# EPALE

Република Северна Македонија  
<http://ec.europa.eu/epale/>